

PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Sot pasdite (e diel, dt. 04) dhe nesër (e hënë, dt. 05) priten reshje me intensitet të lartë kryesisht në veri dhe jug të vendit. Në qarqet Shkodër, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.

Sipas llogaritjeve të IGJEO përgjatë datave (4 - 8 Janar 2026) priten reshje intensive, kryesisht në veri dhe jug të vendit. Këto reshje do të sjellin rritje të rrezikshme të prurjeve dhe niveleve në lumenjtë Drin-Buna, Liqeni Shkodrës, lumi Mat, Shkumbin dhe Vjosë.

PARASHIKIMI METEO

RESHJET

Sot pasdite (e diel, dt. 04) dhe nesër (e hënë, dt. 05) priten reshje shumë intensive në qarkun Shkodër. Në qarqet Kukës, Vlorë dhe Gjirokastrë priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive, ndërsa në qarkun Lezhë priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Në qarqet e tjera priten reshje mesatare. Reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

TEMPERATURA

Nesër (e hënë, dt. 05) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 12 / 16 °C, në vendet e ulëta: 12 / 15 °C, në vendet malore: 5 / 10 °C

ERA

Sot pasdite (e diel, dt. 04) dhe nesër (e hënë, dt. 05) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë në bregdet dhe në veri.

NIVELET E RREZIKUT

S'KA RREZIK

I ULËT

I MODERUAR

I LARTË

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE *(Bulletin on Natural Hazards)*
Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore
 Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 04 / 2026, 04-01-2026

Parashikimi nga 04-01-2026, ora 12:00 deri 05-01-2026, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	shumë intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare					
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare					
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare					
VLORË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				



Instituti i Gjeoshkencave – IGJE

Specialist: Gentiana Stafa

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 2 / 3

